There are no translations available.

Veprimtaria u zhvillua në datën 21 Maj 2012, në Shkollën e Sindikatave të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të BSPSH-së.



Në këtë seminar morrën pjesë 30 sindikalistë, kryesisht kryetarë të federatave dhe anëtarë të këshillit drejtues të sindikatave të Prefekturës së Tiranës.

Në këtë veprimtari, pjesëmarrësit u njohën me një historik të shkurtër të krijimit të Bashkimit Evropian, me konkluzionet e raportprogresit të BE –së për sindikatat si dhe rolin që luan BSPSH në zhvillimin e dialogut social me qeverinë si normë demokratike dhe strategji e sindikatës për rritjen e rolit të saj si faktor për anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

Në këtë veprimtari merrte pjesë edhe **Presidenti i BSPSH-së, zoti Gëzim Kalaja**, i cili u ndal në mënyrë të veçantë në strategjinë e BSPSH-së për të ndërtuar një dialog sa më konstruktiv me partnerët socialë, në nivel qëndror si dhe me përpjekjet e bëra për respektimin e Paktit të Mirëkuptimit nga Qeveria.

Gjatë trajtimit të temave dhe diskutimit të pjesëmarrësve u evidentua roli i sindikatës në një vend demokratik dhe dialogu social si normë dhe kërkesë e BE-së. Gjithashtu u ndalëm në 12

kërkesat e BE-së për pranimin e Shqipërisë si vend kandidat dhe ku ajo e sheh veten e saj si faktor i rëndësishëm lidhur me marrëdhëniet e punës, si dhe problemet sociale të punëtorëve shqiptarë.

SEMINAR RAJONAL I ZHVILLUAR NË RRETHIN E TIRANËS FINANCUAR NGA FONDACIONI FRIEDRICH EBERT STIFTUNG